



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2019:129080

Datë: 03.06.2024

Numri i dokumentit: 05773759

**C.nr.2022:234810**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.H. nga fshati ...-Komuna Ferizaj, rr. ..., me numër personal ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Xhemajl Ahmeti, avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Kompania Regjionale e Mbeturinave (KRM) "P." Sh.A me seli në Ferizaj, rr. "...", nr. ... të cilën e përfaqëson me autorizim A.Q., sekretar, për shkak të anulimit të vendimit, kthimin në vendin e punës, kompensimit të dëmit për shkak të largimit nga puna, vlera e kontestit 33095.78€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik më datë 27.05.2024 në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, kurse më datë 03.06.2024 përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET NË TËRËSI SI E PABAZUAR** kërkesëpadia e paditësit S.H. nga fshati ...-Komuna Ferizaj, rr..., me numër personal ..., me të cilën ka kërkuar që të "aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar ashtu që anulohet vendimi me numër 131 të datës 25.01.2019, i lëshuar nga e paditura KRM P. Sh.A Ferizaj, rr. "...", nr. ..., si i kundërligjshëm, detyrohet e paditura KRM P. me seli në Ferizaj që paditësin ta kthejë në vendin e punës me të gjithë të drejtat dhe obligimet, detyrohet e paditura që të bëjë kompensimin e dëmit për shkak të largimit nga vendi i punës, përkatësisht kompensimin e pagave për periudhën kohore prej datës 01.02.2019 deri më 14.02.2023 dhe atë në emër të pagave neto shumë prej 29,724.42 euro dhe në emër të kontributeve pensionale shumë prej 3371.36 euro, shumë totale në vlerë prej 33095.78 euro, obligohet e paditura KRM P. me seli në Ferizaj që paditësit të ja kompensoj shumë prej 735.77 euro në emër të pagës bruto (duke përfshirë kompensimin për trust pensional dhe tatimin e pagës) për secilin muaj për periudhën pas datës 14.02.2023 deri në kthimin e paditësit në vendin e punës si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 3213.00 euro.

## II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës

### A r s y e t i m

#### Rrjedha e çështjes

Paditësi përmes të autorizuarit të tij Av. Xhemajl Ahmeti nga Ferizaj, ka paraqitur padi në këtë gjykatë, me objekt kontesti kthim në vendin e punës, vlera e papërcaktuar. Në padi ka theksuar se ka qenë i punësuar tek e paditura në pozitën e Zyrtarit të Lartë / Sekretar, përmes konkursit të hapur publik nr. 1289 të dt. 03.06.2015, me vendim të bordit të drejtorëve të të paditurës. Pas skadimit të kontratës së punës e cila kontratë ka qenë për kohë të caktuar, përkatësisht për periudhën nga dt. 03.08.2015-03.08.2018 bordi i drejtorëve të paditurës në mbledhjen e mbajtur më dt. 03.08.2018, me vendim unanim nga të gjithë anëtarët e bordit ka vendosur që nga dt. 03.08.2018, paditësit t’ia vazhdojë kontratën e punës në pozitën e Zyrtarit të Lartë / Sekretar në kohë të pacaktuar. Edhe përkundër se e paditura në vendimin me numër 3...3, të dt. 03.08.2018, ia kishte vazhduar kontratën e punës paditësit, kurse në fund të vendimit kishte përcaktuar si kohë të vlefshmërisë datën kur do të nxirret ndonjë vendim tjetër, të njëjtin vendim nuk e kishin respektuar dhe asnjëherë nuk i ka dorëzuar ndonjë vendim për shkëputjen e kontratës paditësit, duke vepruar kështu nën shkelje ligjore.

Gjykata Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, me Aktgjykimin C.nr.198/19, të dt. 04.03.2020, e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit S.H. nga fshati ... Komuna Ferizaj kundër të paditurës KRM “P.” Sh.A me seli në Ferizaj, si e bazuar, obligohet e paditura që paditësin ta kthejë në vendin e punës Sekretar i Kompanisë KRM “P.” Sh.A me seli në Ferizaj, me të gjitha të drejtat dhe obligimet të përshkruara për këtë pozitë, apo në ndonjë pozitë ekuivalente, në afat prej 7 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, obligohet e paditura që në emër të kompensimit të dëmit për periudhën e largimit nga puna të paditësit për periudhën kohore nga dt. 01.02.2019 deri 04.03.2020 ti paguaj paditësit shumën prej 7824,18€ me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë më 25.02.2019 deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 529€, të gjitha në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë në emër të kompensimit të të ardhurave në lartësi prej 1657.75€ dhe në emër të shpenzimeve të procedurës në lartësi prej 781,6€.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin AC.nr.1916/20, të dt. 18.08.2022, e ka aprovuar të themeltë ankesën e të paditurës Kompania Regjionale e Mbeturinave (KRM) P. Sh.a

me seli në Ferizaj, prishen pikat I, II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.198/19, të dt. 04.03.2020 dhe lënda për këtë pjesë i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje, pika e IV-të e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.198/19, të dt. 04.03.2020, mbetet e pashqyrtuar.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij Av. Xhemajl Ahmeti nga Ferizaj, në riprocedurë, gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka bërë precizimin definitiv të kërkesëpadisë dhe në fjalën përfundimtare, ka kërkuar nga gjykata që aprovet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar ashtu që anulohet vendimi me numër 131 të datës 25.01.2019, i lëshuar nga e paditura KRM P. Sh.A Ferizaj, rr. "...", nr. ..., si i kundërligjshëm, detyrohet e paditura KRM P. me seli në Ferizaj që paditësin ta kthejë në vendin e punës me të gjithë të drejtat dhe obligimet, detyrohet e paditura që të bëjë kompensimin e dëmit për shkak të largimit nga vendi i punës, përkatësisht kompensimin e pagave për periudhën kohore prej datës 01.02.2019 deri më 14.02.2023 dhe atë në emër të pagave neto shumë prej 29,724.42 euro dhe në emër të kontributeve pensionale shumë prej 3371.36 euro, shumë totale në vlerë prej 33095.78 euro, obligohet e paditura KRM P. me seli në Ferizaj që paditësit të ja kompensoj shumë prej 735.77 euro në emër të pagës bruto (duke përfshirë kompensimin për trust pensional dhe tatimin e pagës) për secilin muaj për periudhën pas datës 14.02.2023 deri në kthimin e paditësit në vendin e punës si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 3213.00 euro. Faktet e vërtetuara nga gjykata se paditësi ka qenë i punësuar tek e paditura për periudhën 03.08.2015-03.08.2018 është dëshmuar me kontratën e punës dhe i njëjti fakt nuk është kundërshtuar nga pala e paditur, faktin se paditësit nga e paditura i është vazhduar kontrata me kohë të pacaktuar është dëshmuar me vendimin me numër 0... i dt. 03.08.2018 i cili fakt/vendim nuk është kontestuar nga pala e paditur, fakti se paditësi nuk është njoftuar asnjëherë me shkrim përkatësisht se nuk ka marrë ndonjë njoftim apo vendim për shkëputjen e marrëdhënies së punës është dëshmuar nga deklaratat e paditësit e poashtu është pranuar nga ana e përfaqësuesit të paditurës në tri seanca (dt. 08.01.2020, 17.12.2019 dhe 12.04.2023), andaj e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e saj ligjor që rrjedh nga neni 71 dhe 72 nga Ligji i Punës. Është dëshmuar se vendimi i dt. 25.01.2019 me nr. ... është nxjerrë në procedurë jo të rregullt ligjore dhe kjo është dëshmuar me procesverbalin e dt. 25.01.2019 në verzionin me shkrim dore nuk është marrë ky vendim, me procesverbalin e dt. 25.01.2019 në verzionin me shkrim me kompjuter nuk është marrë ky vendim, me fotografinë e bërë në librin e protokollit të të paditurës shihet se janë përshkruar dy vendime në të njëjtin numër të protokollit, pra në numrin ... dhe kjo dëshmon se ky vendim është nxjerrë në mënyrë jo të rregullt, me vendimin me të cilin ishte aprovuar një kërkesë e një klienti/pale të tretë, e që mban të njëjtin

numër pra numrin 131 dhe dt. 25.01.2019. Pra me anë të këtyre provave shihet se ky vendim është përshkruar më vonë, pra e paditura nuk e ka nxjerrë këtë vendim në mbledhje të bordit por më vonë duke bërë kështu edhe një falsifikim në librin e protokolit pasi që e ka përshkruar një vendim mbi numrin e një vendimi tjetër, duke i nxjerrë kështu dy vendime me të njëjtin numër dhe me të njëjtën datë. Po ashtu kundërligjshmëritë e këtij vendimi, përkatësisht procedura jo e rregullt formalo-ligjore është vërtetuar edhe me dëgjimin e dëshmitarëve të propozuar dhe të dëgjuar gjatë seancës së dt. 19.06.2023 të cilët kanë përshkruar faktin se procesverbalet janë të pandryshueshëm, përkatësisht mund të përmirësohen vetëm teknikisht, por në asnjë rast të konstatohet se është marrë ndonjë vendim në mbledhjet e mbajtura. Një fakt tjetër që dëshmon se vendimi ...1 i dt. 25.01.2019 nuk është marrë në këtë datë por më vonë, kurse numri i vendimit edhe data e tij është shënuar kundërligjshëm dëshmohet mbi bazën e deklaratës së dëshmitarit Habib Krosa, i cili në seancën e dt. 19.06.2023 kishte dëshmuar se “këto vendime i ka përpiluar sekretari A.Q.”, mirëpo është fakt i pakontestueshëm se me dt. 25.01.2019 sekretar i kompanisë ka qenë paditësi, pra siç mund të shihet paditësi është larguar nga vendi i punës pa ndonjë vendim, përkatësisht të njëjtit asnjëherë nuk i’u është dorëzuar ky vendim, kurse vendimi 131 i dt. 25.01.2019 edhe pse evidentohet me këtë numër dhe datë nuk është nxjerrë në këtë datë por është nxjerrë pas largimit të paditësit nga marrëdhënia e punës. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar A.Q. nga Ferizaj, në përgjegjje në padi, në riprocedurë, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare duke i kundërshtuar të gjitha pretendimet e palës paditëse ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar për arsye se Bordi i Drejtorëve të KRM “P.”, Sh.A në Ferizaj, shfuqizimin e vendimit nr. ...3 të datës 03.08.2018, e ka bazuar në konkursin nr....1, respektivisht me përfundimin e procedurave të konkursit dhe zgjedhjen e kandidatit që i ka plotësuar kriteret për pozitën e sekretarit të kompanisë. Sa i përket pretendimeve të palës paditëse se të njëjtit i është vazhduar kontrata e punës deri në afat të pacaktuar, nuk qëndrojnë, pasi që bordi i të paditurës përveç nxjerrjes së vendimit nr. 3...3 të dt. 03.08.2018 që ka qenë vazhdim i kontratës për ushtrimin e detyrës deri në marrjen e një vendimi tjetër respektivisht derisa të përfundojnë procedurat e përzgjedhjes së kandidatit të suksesshëm për konkursin nr... i shpallur për pozitën Zyrtar i lartë / Sekretar, me arsyen që të mos krijohet boshllëk në administratën e kompanisë e jo vazhdimin e kontratës siç pretendohet duke u bazuar në faktin që e e paditura asnjëherë nuk ka ripërrirë kontratë me paditësin pasi që kontratë të nënshkruar nga të dyja palët punëdhënës-punëmarrës siç e parasheh Ligji i punës për mandatin 3 vjeçar siç e parasheh Ligji për ndërmarrjet

publike asnjëherë nuk është bërë, nga pala paditëse e kemi kërkuar në çdo seancë të na e prezantojnë por nuk e kanë bërë një gjë të tillë. E paditura duke u bazuar në konkursin nr. 1289 të dt. 03.06.2015, vërteton që paditësi, ka aplikuar në pozitën Zyrtar i lartë/Sekretar me mandat tre vjeçar, ku me vendimin e Bordit të Drejtorëve nr.... të datës 06.08.2015, vërtetohet se i njëjti është emëruar në këtë pozitë me mandat tre vjeçar dhe me të njëjtin është lidhur kontrata nr.1823 me datë 06.08.2015 dhe e njëjta ka skaduar me datë 03.08.2018. Për arsye të skadimit të kontratës së të njëjtit, bordi i drejtorëve ka nxjerrë vendimin nr.... të datës 03.08.2018, i cili ka qenë vazhdim i kontratës për ushtrimin e detyrës deri në marrjen e një vendimi tjetër, me arsyetimin që mos të krijohet boshllëk në administratën e kompanisë dhe kjo nuk ka nënkuptuar ripërtirjen e kontratës, pasi që për një gjë të tillë nevojitet kontrata e nënshkruar nga të dyja palët siç parasheh Ligji i Punës Nr.03/L-212. Për këtë arsye pra të skadimit të kontratës, bordi i drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më 20.08.2018 ka marrë vendimin nr. ... dhe ka shpallur konkurs për pozitën zyrtar i lartë / sekretar i kompanisë. Konkursi nr. ... i dt. 30.08.2018 për pozitën zyrtar i lartë / sekretar ka qenë i publikuar në ëeb faqe të kompanisë dhe në shtypin ditor i hapur për 15 ditë duke filluar nga dt. 31.08.2018-14.09.2018 dhe paditësi pasi që e ka ditur që kontrata nr. ... i ka skaduar dhe vendimi nr. ... i dt. 03.08.2018 ka qenë i përkohshëm deri në marrjen e një vendimi tjetër ai ka aplikuar në konkursin e pala paditëse gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka arritur që të prezantoj një kontratë të tillë për të cilën pretendon se është lidhur. Sa i përket vendimit nr. ..., bordi i drejtorëve e ka nxjerrë për shkak të procedurës ngase edhe po të mos nxjerrjes një vendim i tillë vendimi nr... është shfuqizuar në momentin kur bordi i drejtorëve ka nxjerrë vendimin nr. ... për shpalljen e konkursit për pozitën e sekretarit të kompanisë, përkatësisht që nga momenti i përfundimit të procedurave të konkursit nr. ... dhe përzgjedhjes së kandidatit tjetër, paditësi nuk ka qenë në marrëdhënie pune me të paditurën, gjithashtu paditësi ka qenë i njoftuar që nga shpallja e konkursit të parë nr. ... për pozitën e sekretarit dhe mbi të gjitha nga skadimi i kontratës së punës që e ka pasur me mandat 3 vjeçar dmth nga dt. 03.08.2018, e paditura nuk ka themeluar marrëdhënie të punës me te sepse nuk ka marrëdhënie pa kontratë por vetëm ia ka mundësuar ushtrimin e detyrës deri në shpalljen e konkursit dhe nëse ishte përzgjedhur pas zhvillimit të procedurave konkurrese bazuar në ligj do të gjenerohej kontrata me mandat 3 vjeçar por përderisa kjo nuk ka ndodhur paditësi nuk ka bazë juridike që të kërkon kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e pagave. Ekspertizën financiare e ka kundërshtuar sepse është në kundërshtim me mbajtjen e seancave, shqyrtimin e provave dhe dëgjimin e dëshmitarëve pasi që në fillim nga pala paditëse prejdukohet epilogu përfundimtar, prandaj pala paditëse ose nga mosdija apo dëshira për të na manipuluar të gjithëve kërkon kompensimin e pagave deri tani ose deri në përfundimin e lëndës apo ndoshta edhe deri në pension, kur dihet

bazuar në Ligjin për Ndërmarrjet Publike mandati i zyrtarëve të lartë është 3 vjeçar për atë edhe paditësi kontratën e ka pasur me mandat në kohëzgjatje prej 3 viteve. Nga të lartcekurat ka kërkuar që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit dhe të gjitha shpenzimet e procedurës ti bartë paditësi.

### **Provat e administruara në shqyrtimin kryesor**

Gjykata për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse, ka administruar këto prova materiale:

1. Vendim i Bordit të Drejtoreve të paditurës i datës 03.08.2018, me numër ...3;
2. Kontrate punësimi mes paditësit dhe te paditurës me numër 1... i datës 06.08.2015;
3. Vendim i Bordit te Drejtoreve te paditurës i datës 06.08.2015, me numër ...1;
4. Vendim i Bordit te Drejtoreve te paditurës i datës 25.01.2019, me numër ...1;
5. Vendim i Bordit te Drejtoreve te paditurës i datës 28.01.2019 me numër ...6;
6. Konkurs i te paditurës me numër 4... i datës 13.11.2018;
7. Konkurs i botuar ne gazetën e përditshme Koha Ditore pa date;
8. Konkurs i te paditurës me numër i 1... i datës 03.06.2015;
9. Vendim i Bordit te Drejtoreve te paditurës i datës 30.08.2018, me numër 3...;
10. Konkurs i te paditurës me numër 3..., i datës 30.08.2018;
11. Njoftim për anulim te konkursit i datave 27.09.2018;
12. Konkurs i te paditurës i datës 09.10.2018 me numër 3..., i publikuar;
13. Njoftim për anulim te konkursit i datave 09.11.2018;
14. Ankese e paditësit kundër njoftimit nr. ... date 28.01.2019, me numër ... i dt. 01.02.2019;
15. Vendim i Bordit te Drejtoreve te paditurës i datës 14.02.2019, me numër ...1;
16. Vërtetim i datës 14.09.2018;
17. Fotografi A4 e librit te protokollit te paditurës;
18. Vendim numër ... i datës 25.01.2019 për N.K.;
19. Procesverbali i përpiluar me dore i mbledhjes se bordit te drejtoreve te paditurës i datës 25.01.2019;
20. Procesverbali i mbledhjes se bordit te drejtoreve te paditurës i datës 25.01.2019 i protokolluar me date 04.02.2019 me numër ...2;
21. Raport i punës se sekretarit i datës 21.01.2019, me numër 91 për periudhën janar- dhjetor 2018;
22. Pese fotografafi flete A4 te librit te arkivit te paditures- protokolli;

23. Procesverbal lidhur me mbledhjen e bordit te drejtove te datës 05.02.2019 i përpiluar me dore dhe ne forme te shkruar, i protokolluar me numër 5..., i datës 22.03.2018 dhe
24. Ekspertiza financiare e ekspertit gjyqësor M.Sh. nga Ferizaj dhe plotësimi i ekspertizës e te njëjtit ekspert e datës 26.03.2023.

Nga leximi i Vendimit të Bordit te Drejtove i të paditurës me numër 1821, i datës 06.08.2015, vërtetohet se paditësi me datën 21.07.2015 emërohet Sekretar i Kompanisë KRM “P.” sh.a Ferizaj me mandat 3 (tre) vjeçar.

Nga leximi i Kontratës së punësimit mes paditësit dhe të paditurës me numër 1...3, i datës 06.08.2015, vërtetohet se paditësi dhe e paditura kishin lidhur kontratë punësimi për pozitën e Zyrtarit të Lartë / Sekretarit të Kompanisë, ku emërimi është bërë për një periudhë e cila fillon më 03.08.2015 me vendim të Bordit të Drejtorëve të dt. 21.07.2015 që njëherit është data e miratimit të këtij emërimi nga Bordi i Drejtorëve, deri me 03.08.2018.

Nga leximi i Vendimit të Bordit te Drejtove i të paditurës me numër 3..., i datës 03.08.2018, vërtetohet se paditësit i vazhdohet kontrata e punës si Sekretar i Kompanisë Regjionale për Mbeturina “P.” Sh.A Ferizaj deri në një vendim tjetër.

Nga leximi i Vendimit të Bordit te Drejtove i të paditurës me numër ...1, i datës 25.01.2019, pika I. shfuqizohet vendimi nr. 3...3 të dt. 03.08.2018 për vazhdimin e kontratës së sekretarit të kompanisë Krm P. sh.a Ferizaj i paraparë të jetë në fuqi deri në një vendim tjetër dhe pika II. shfuqizoj vendimin nr. 3...4 të dt. 03.08.2018 për vazhdimin e kontratës së zyrtarit të lartë për financa dhe thesar “Krm P.” sha në Ferizaj i paraparë të jetë në fuqi deri në një vendim tjetër.

Nga leximi i Vendimit i Bordit te Drejtove te paditurës me numër ... i datës 28.01.2019; vërtetohet se z. A.E.Q. nga komuna Ferizaj, me numër personal ... i lindur me ... me profesion jurist i diplomuar, me dt. 25.01.2019 emërohet sekretar i kompanisë KRM “P.” Sh.A Ferizaj me mandat tre vjeçar.

Nga leximi i Vendimit i Bordit te Drejtove te paditurës i datës 30.08.2018, me numër 3474, vërtetohet se është vendosur të shpallet konkursi për pozitën e zyrtarëve të kompanisë si: Sekretar i Kompanisë dhe Zyrtar kryesor për financa dhe thesar të paditurës.

Nga leximi i Vërtetimit i dt. 14.09.2018 i lëshuar nga e paditura, përmes kryeshefit ekzekutiv, vërtetohet se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në punë dhe detyra të punës zyrtar i lartë / sekretar i kompanisë nga dt. 03.08.2015 dhe vazhdon të punojë ende.

Nga raporti i punës së sekretarit të kompanisë për periudhën janar – dhjetor 2018, i lëshuar nga sekretari S.H., i dt. 21.01.2019, i protokolluar me nr. ..., i dt. 21.01.2019, vërtetohet se është paraqitur nga sekretari i kompanisë raporti i punës për periudhën janar – dhjetor 2018 për bordin e drejtorëve të KRM P. me seli në Ferizaj dhe kryeshefin ekzekutiv të KRM P. me seli në Ferizaj.

Me leximin e Ekspertizës financiare të ekspertit gjyqësor M.Sh. nga Ferizaj dhe plotësimi i ekspertizës e te njëjtit ekspert e datës 26.03.2023, vërtetohet se gjatë përpilimit të kësaj eksperti ekspert gjyqësor ka ardhur në këto përfundime: - total shuma e pagave neto për periudhën prej dt. 01.02.2019 deri më 14.02.2023 arrin vlerën prej 29.724,42€ dhe total shuma në emër të kontributeve të trustit pensional 3.371,36€, në total 33.095,78€.

Deklarata e paditësit e dhënë në cilësi të palës në seancën e dt. 12.04.2023, ku i njëjti potencon se: jam punësuar ne vitin 2015, kontrata e pare e punës ka qene me afat 3 vjecar, ditën e skadimit te kontratës bordi me ka vazhduar kontratën me vendim me afat te pa caktuar sa me kujtohet mua viti ka qene 2018, po kam vazhduar te punoje nejt me te gjitha te drejtat dhe obligimet, e kam pasur edhe te drejtën qe ta përfaqësojë kompaninë sepse kam punuar si jurist ( sekretar ), unë kam punuar deri ne shkurt te vitit 2019, nga puna jam larguar pa paralajmërim – vendim, asnjëherë nuk kam pranuar vendim se jam larguar nga puna , verbalisht jam larguar nga puna, pas largimit nga puna unë kam vazhduar me procedurat gjyqësore – kam ushtruar padi pranë gjykatës ne vitin 2019 per ti realizuar te drejtat e mia me te cilat un mendoj se e paditura ne mënyre jo ligjore me ka larguar nga puna, nuk kam pranuar asnjëherë vendim e kam kuptuar ne gjykate, me ato prova vërtetojnë kundërligjshëm e vendimit nga pala e paditur për largimin e nga puna, procesverbali e datës 25.01.2019 është procesverbal i mbledhjes se bordit te cilës e kam siguruar un deri sa kam qene ne vendin e punës, vendimi është ne kohe te pa caktuar, po ka pasur konkurs, un nuk kam e kundërshtu, kam konkuruar ne këtë konkurs për te mbrojtur vendim tim te punës, mu ka vazhduar kontrata ne kohe te pa caktuar deri ne pension, po kam konkuruar edhe ne konkursin e dyte, nuk me kujtohet nëse ka pasur konkurs për herë të tretë, po un i kam përpiluar vendimin për shpalljen e konkursit, un nuk pranuar vendim për largimin nga puna nuk kam pasur mundësi me u anku.



Deklarata e dëshmitarit S.H., e dhënë në shqyrtimin e dt. 19.06.2023, ku thuhet se ne KRM P. kam qene kryesues i bordit, kryesues kam qenë rreth 4 vite, ky vendim është marr duke pasur parasysh skadimin e kontratës te sekretarit, mirëpo bordi ka nxjerr një vendim te përkohshëm për mos me lenë vendin vakant ( zbrazet) te sekretarit ky vendim ka qene deri ne nxjerrjen e vendimit tjetër , ndërsa vendimi i radhës ka qene hapja e konkursit për sekretar dhe zyrtar financiar ne te njëjtën kohe, vendimet e bordit i bene sekretari sepse ne baze te ligjit është këshilltar ligjor i bordit dhe vendimet dhe procesverbalet i përgatit sekretari i bordit, nuk me kujtohet sakte përmbajtja e vendimit se ka kaluar një kohe por mendoj se ka pasur te beje me zgjidhjen e sekretarit e te cilat konkurse janë përsërit shume here për shkak se nuk kemi mundur me zgjedh sekretarin, sepse nuk i kane plotësuar kushtet sipas konkursit, nuk ka pasur kontrate por vetëm e kemi vazhdu përmes vendimit, po është hapur konkursi për dy zyrtare , për sekretarin – zyrtar ligjor – zyrtarin financiar, po ka qene edhe hartues i kriterëve për pranimin e sekretarit dhe zyrtarit financiar si dhe ka qene kandidat për zyrtar ligjor, pas rezultateve te kandidateve nga ana e komisioneve si dhe pas pranimit te kandidateve bordi e ka miratuar vendimin e komisionit dhe e ka shfuqizuar vendimin ...3, procesverbali mesa e di un miratohen ne mbledhjen e ardhshëm te bordit i cii dërgohet ne mënyre elektronike te bordit dhe ne mbledhjen vijues edhe pike e veçante e rendit te ditës me plotësim dhe ndryshim ku behet edhe miratimi i procesverbalit te seancës se kaluar, ne nuk i ndryshojmë asnjëherë vendimet, ne secilën mbledhje ka kërkesa për ndryshim te procesverbalit nuk me kujtohen sakt se cilat kane qene kërkesat, si e ka lëshuar vendin e punës sekretari kështu mendoj unë se i ka kaluar kontrata, nese pranohet me konkurs te rregullt dhe me kontrate, kontrata duhet te jete e nënshkruar nga te dyja palët, sipas ligjit te ndërmarrjeve publike qe i kemi përdor edhe hapjen e konkursit për zyrtare te lart gjithë here e kemi parapare qe te jete një kontrate 3 vjeçare, jo nuk kemi pasur asnjë kërkesë për parregullsi nga ana e sekretarit tani paditësit ( sepse sekretari vete ka qene hartues i këtyre vendimeve dhe kriterëve, nuk me kujtohet sepse ka kaluar një kohe e gjate ne mbledhjen e datës 25.01.2019 kush e ka mbajt procesverbalin, jo nuk me kujtohet sepse ka kaluar një kohe e gjate kur është marr vendimi për shfuqizimin te vendimit 3033, këto ndryshime ne procesverbale te mbledhjes se ardhshme çfarë karakteri kane pasur kanë pasur karakter korrigjues, kane te bëjnë me korrigjime teknike gjuhësore apo i keni ndryshuar edhe vendimet, nuk e di a ju ka dorëzuar vendimi sepse un si kam dorëzuar vendimet këto i dorëzon zyra ligjore

Deklarata e dëshmitarit D.E., e dhënë në shqyrtim ka deklaruar ne kompaninë KRM kame qene ne pozitën e krye shefit ekzekutiv, nuk me kujtohet data dhe viti kur i ka skaduar kontrata tani paditësit S.H. sepse ka kaluar një kohe e gjate, pas skadimit te afatit te sekretarit tani paditësit

pozita e tij është ne mesin e katër pozitave te larta qe i parasheh ligji për ndërmarrje publike, kjo pozite ka qene me kohe te caktuar mandat dhe e vetmja mënyrë me vazhdu punën ka qene konkursit, me bordin i kemi vazhdu qe ta kryejnë punën e sekretarit deri ne shpalljen e konkursit tjetër si dhe deri ne zhvillimin e procedurave te rekrutimit, sekretari është zgjedhur me vendim mandator 3 vjeçar nuk ka pasur kontrate se nuk ka lejuar ligji qe te hartojmë kontrata, procesverbali mbahet gjate mbledhjes me shkrim – laps dore me pastaj ne mënyre elektronike dhe dërgohet tek anëtarët e bordit ne rast se anëtarët e bordit kane ndonjë vërejte ne mbledhjen e radhës plotësohet procesverbali dhe ne te njëjtën mbledhje miratohet ( ne rast se pajtohen anëtarët e bordit ), nuk me kujtohet qe kemi marr vendim për shfuqizimin vendimit 3033 por ne parim vetvetiu shfuqizohet sepse ka qene pozitë mandatore dhe shfuqizohet, te gjitha procedurat e konkursit behën përmes sekretarit , nuk ka pasur ankesa lidhur me shpalljen e konkursit, i njëjti ka aplikuar për pozitën e sekretarit, vetëm gabimet teknike përmirësohen, vendimi për shfuqizimin e vendimit 3..., unë nuk ja kam dorëzuar nuk e di a e ka dorëzuar dikush tjetër.

Deklarata e dëshmitarit H.K., e dhënë në një shqyrtim ka deklaruar se po jam kanë procesmbajtës ne këtë mbledhje te datës 23.01.2019, meqenëse ka kaluar një kohe e gjate nuk mundem me dit detaje qa është shkruar ne procesverbal mirëpo e di qe un e kam mbajt procesin, procesverbali qe mbahet me dore eshte procesverbal me i sakt sepse aty shënohen drejte për drejte qka flitet nga anëtar e bordit, jo un nuk kam përpiluar asnjë vendim, te gjitha vendimet procesverbalet qe përpilohen janë detyre e sekretarit, këto vendime i ka përpiluar sekretari A.Q., un jam caktuar nga bordi për me majte procesin e dt. 25.01.2019, sa me kujtohet mua paditësi S.H. ka qene tu punu në atë kohë, un kam majt shpesh her procesverbale por nuk e di sakt a kam qene edhe ne mbledhjen e radhës si procesmbajtës por këtë mund te deshmoje fletorja e procesverbalit.

### **Zbatimi i së drejtës materiale**

Gjykata, deri te vendosja si në dispozitiv të këtij aktgjykimi erdhi duke zbatuar dispozitat ligjore nga Ligji Nr.03/L-212 i Punës i Kosovës, edhe atë dispozitat nga neni 2, paragrafi 1 dhe 2 i cili përcakton se “Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës. 2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës”; neni 8, paragrafi 1 dhe 2 se “Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik

sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës. Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi”; në nenin 78, paragrafi 1 të Ligjit të Punës, është paraparë se: “I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të tij”. Në nenin 78, par. 2 të Ligjit të Punës është paraparë se: “Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës”. Ndërsa në nenin 79 të të njëjtit ligj është paraparë se: “Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 par.2 i këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të iniciojë kontest pune në Gjykatën Kompetente”; Neni 80 i Ligjit të Punës parasheh se: “Vendosja gjyqësore lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës 1. Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njëren prej këtyre dëmshpërblimeve: 1.1. t’i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shuma të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit; ose 1.2. nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthej të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna. 2. Punëdhënësi është i obliguar që në afatin e caktuar të zbatoj vendimin e gjykatës kompetente”

Neni 5.1 i Ligjit të Punës parasheh se: “1. Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi.”

Ligji nr. 06/L-114 për Zyratë Publik i Kosovës, në nenin 68, par. 2 ka paraparë shpallja e konkurrimit, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përfshin përshkrimin e punës për pozitën apo përshkrimin e përgjithshëm të punës për grupin përkatës, pozitën apo pozitën e punës së lirë në grupin përkatës, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që duhet t’i plotësojnë kandidatët dhe të

dhëna të hollësishme për zhvillimin e procesit të konkurrimit, përzgjedhjes dhe dokumentacionin që duhet paraqitur për aplikim”, kurse në par. 5 të po të njëjtit nen, parashihet se “vlerësimi bëhet nëpërmjet një testimi me shkrim apo teknike tjetër ekuivalente për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale dhe një interviste me gojë”. Ndërkaq, neni 69 i po të njëjtit ligj në par. 1 ka paraparë se “në rastin e konkurrimit të organizuar për një pozitë të vetme, kandidati që ka marrë më shumë pikë dhe është vlerësuar mbi nivelin minimal është kandidati fitues”, par.2 parasheh se në rastin e konkurrimit të organizuar për grup-pozita të njëjta, kandidatët e listës fituese, sipas nenit 34 të këtij ligji, duke filluar nga ai me më shumë pikë, kanë të drejtën të zgjedhin secilën pozitë të lirë të grupit për të cilin është zhvilluar konkurrimi.

Dispozitat ligjore nga Ligji nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Kosovës, edhe atë dispozitat nga neni 21, paragrafi 1 parasheh se: “21.1 Zyrtarët e NP emërohen nga Bordi i Drejtorëve të NP. Zyrtarët shërbejnë për Bordin dhe Bordi mundet në çdo kohë dhe me shumicë votash ta ndërpresë kontratën e tyre me ose pa deklarinimin e arsyes. Pavarësisht nga sa u tha më sipër, Komisioni i Auditimit ka kompetencën ekskluzive për emërimin dhe shkarkimin e Zyrtarin për Auditim të Brendshëm, i cili shërben për Komisionin e Auditimit, i cili mundet, në çdo kohë dhe me shumicë votash, ta ndërpresë kontratën e këtij zyrtari me ose pa deklarinimin e arsyes. Ky Nen 21.1 mbizotëron mbi çdo dispozitë kontraktuese të themeluar me kontratë ose ligj, dhe do të pasqyrohet në Rregulloren e NP-së.” Ndërsa neni 21, paragrafi 4 i cili përcakton se “Për përzgjedhjen së personave për emërim si zyrtarë të NP-së, Bordi i Drejtorëve duhet të kryejë një procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese e cila ka për qëllim që të gjitha emërimet të bëhet ekskluzivisht në bazë të meritës. Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të gjithë personat e emëruar si zyrtarë të jenë person me integritet të njohur të cilët (i) i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas Nenit 17.1, (ii) i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) dhe (iii) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë; me kusht që (i) Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit të posedojë diplomë universitare dhe përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e financave dhe/ose kontabilitetit; (ii) Këshilltari i Përgjithshëm / Sekretari i Korporatës të posedojë diplomë universitare në ligj dhe përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtës së shoqërive tregtare; dhe (iii) Zyrtari për Auditim të Brendshëm të jetë person ekspert në kontabilitet.”.

Sipas nenit 14, par. 2, pika 2.9 të Statutit të KRA P. SH.A të aprovuar më 19.07.2018, parashihet se: “Emëron me propozim të KE dhe largon apo zëvendëson ZKF (Zyrtarin Kryesor

Financiar) dhe Sekretarin dhe përcakton në bazë të propozimit të komisionit të auditimit kompenzimin e tyre;” pika 2.10 “kryej mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigorozë mbi punën e biznesit të kompanisë mbi punën e KE, ZKF dhe Sekretarit .....”, neni 16: “Zyrtarët e kompanisë janë: Kryeshefi Ekzekutiv, Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv, Zyrtari Kryesor Financiar, Sekretari, Zyrtari i Auditimit të Brendshëm dhe zyrtar të tjerë të caktuar nga Bordi i Drejtorëve.” Sipas nenit 16 të Statutit të paditurës, Sekretari i Kompanisë (“sekretari”) do të jetë përgjegjës: 1.6. Sekretari do të mbaj procesverbalin e secilës mbledhje të përgjithshme të bordit të drejtorve dhe komisionit të auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesi i tyre) dhe do ti shënoj ato në librat e protokolleve. Procesverbali do të përmbajë këto informata: emrat e personave pjesëmarrës, vendin dhe kohën e mbledhjes, çështjet kryesore të ngritura gjatë diskutimit të pikave të veqanta të agjendës, tekstin e veprimeve të propozuara, rezultatin e secilit votim dhe të votave të secilit individ (pjesëmarrës), tekstin e saktë të vendimeve të arritura si dhe çfarëdo kundërshtimi i ngritur në lidhje me vendimet e marra; 1.7. Procesverbali për mbledhjet e përgjithshme do të nënshkruhet nga kryesuesi i mbledhjes së përgjithshme dhe nga sekretari dhe do të dërzohet për aprovim në mbledhjen e ardhshme të përgjithshme. Sekretari do të lëshoj kopje të certifikuara të procesverbalit. Procesverbali i mbledhjes së përgjithshme do tu vihet aksionarëve në dispozicion me kërkesën me shkrim 1.8. Procesverbali i secilës mbledhje të bordit të drejtorëve për aprovim në mbledhjen e ardhshme të bordit të drejtorve. Procesverbali i secilës mbledhje të bordit të drejtorëve do të nënshkruhet nga ana e kryesuesit të bordit të drejtorëve dhe do tu shpërndahet anëtarve të bordit të drejtorëve. Të njëjtat rregulla do të zbatohen për procesverbalet e komisionit të auditimit.”

### **Vlerësimi i provave**

Gjykata në riprocedurë pas marrjes në konsideratë të gjitha sugjerimeve dhe udhëzimeve të Gjykatës së Apelit e Kosovës në Prishtinë, në bazë të çmuarjes me kujdes dhe ndërgjegje të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në nenin 8 të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi përkatësisht duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pabazuar, ngase:

Mes palëve ndërgjyqëse nuk rezulton të jetë kontestuese se paditësi me të paditurën kishte lidhur kontratë punësimi prej dt. 03.08.2015 deri me 03.08.2018, në cilësinë e Sekretarit të Kompanisë, gjë që vërtetohet nga leximi i kontratës së punësimit me numër me numër ..., i datës 06.08.2015.

Mes palëve ndërgjyqëse nuk rezulton të jetë kontestuese se e paditura përmes një vendimi (me numër ...3, i datës 03.08.2018) paditësit ia kishte vazhduar kontratën e punës deri në një vendim tjetër.

Mes palëve ndërgjyqëse është kontestues ligjshmëria e vendimit me numër ..., i datës 25.01.2019, të lëshuar nga Bordi i Drejtorëve të paditurës si dhe kontestuese mbetet e drejta e paditësit për t'u kthyer në vendin e njëjtë të punës.

Si pikë fillestare dhe relevante për këtë gjykatë është çështja e themelimit të marrëdhënies së punës së paditësit me të paditurën. Siç u potencua edhe më lart, nga shkresat e lëndës del se paditësi me të paditurën kishte themeluar marrëdhënien e punës sipas kontratës së punësimit, edhe atë për periudhën prej dt. 03.08.2015 deri me 03.08.2018. Sipas nenit 3, par. 1, nënpar. 1.11 të Ligjit të Punës parashihet se: “1.11. Kontrata e Punës - akti individual e cila lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit, me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në pajtim me këtë ligj, me Kontratën Kolektive dhe me Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit;” Kurse sipas nenit 10, par. 1 të Ligjit të Punës parashihet se: “1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuarit. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji.”, 10.2: “2. Kontrata e Punës mund të lidhet për: 2.1. një periudhë të pacaktuar; 2.2. një periudhë të caktuar; dhe 2.3. për punë dhe detyra specifike.” Ndërsa përmbajtja e kontratës së punës rregullohet me dispozitat e nenit 11 të Ligjit të Punës. Ndërkaq e paditura përmes një vendimi me numër 3033, i datës 03.08.2018, kishte vendosur që ti vazhdohej marrëdhënia e punës paditësit tek e paditura deri në një vendim tjetër.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate dispozitat ligjore të Ligjit të Punës e kanë përcaktuar mjaft qartë, në mënyrë të strukturuar dhe decidive se marrëdhënia e punës themelohet me anë të kontratës së punës. Kontrata e punës sipas ligjit mund të lidhet për një periudhë të pacaktuar; një periudhë të caktuar dhe për punë dhe detyra specifike. Nga kontrata e punësimit, e lidhur mes paditësit dhe të paditurit del se kontrata e punës së paditësit ishte për periudhë të caktuar. Në asnjë dispozitë të Ligjit të Punës, nuk mund të gjejmë nen i cili thotë se me vendim mund të vazhdohet kontrata e punës. Me vetë faktin se kontrata e punësimit ishte lidhur për kohë të caktuar, ajo përmbante datën e fillimit të punës, kohëzgjatjen e kontratës së punës, përfundimin e marrëdhënies së punës. Ndërsa sipas dispozitës së nenit 11, pika 1.13 të Ligjit të Punës të drejtat dhe detyrimet të cilat nuk janë të përcaktuara me Kontratën e Punës, rregullohen me dispozitat e këtij ligji, Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit, ku nga analizimi i këtyre

dispozitave ligjore mund të vijnë në përfundim se nëse themelimi i marrëdhënies së punës bëhet me një akt juridik p.sh kontratë, edhe vazhdimi duhet të bëhet me aktin juridik të njëjti p.sh kontratën e re. Nga ky analizim i dispozitave ligjore vijnë në përfundimin e drejtë se pretendimi i paditësit se kinse i njëjti ka themeluar marrëdhënie pune me kohë të pacaktuar me të paditurën dhe se kinse i njëjti ende është ligjërish i punësuar tek e paditura nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Në këtë analizë ligjore gjykata mbështetet në dispozitat e nenit 2.2 të LPK, të cilat përcaktojnë se: “2.2 Gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale.”

Sipas thënieve të paditësit dhe sipas pretendimeve të padisë dhe kërkesëpadisë së tij rezulton që paditësit i është shkëputur marrëdhënia e punës faktikisht prej dt. 01.02.2019 prej kur më ai nuk është duke ushtruar funksionin e sekretarit të kompanisë KRM P. me seli në Ferizaj.

Bordi i Drejtorëve të paditurës, shfuqizimin e vendimit nr. ...3 të dt. 03.08.2018 e ka bazuar në konkursin nr. ...1 respektivisht me përfundimin e procedurave të konkursit të lartëcekur, me zgjedhjen e kandidatit që i ka plotësuar kushtet për pozitën Sekretar i Kompanisë.

Pretendimi i paditësit se Bordi i Drejtorëve të paditurës ia ka vazhduar të njëjtit kontratën e punës deri në kohë të pacaktuar, nuk qëndron, pasi që ky bord përveç nxjerrjes së vendimit nr. .. të dt. 03.08.2018, që ka qenë vazhdim i marrëdhënies së punës deri në marrjen e një vendimi tjetër, respektivisht deri sa të përfundojnë procedurat e përzgjedhjes së kandidatit të suksesshëm për konkursin nr. ...1 i shpallur për pozitën Zyrtar i Lartë / Sekretar me arsyen që të mos krijohet boshllëk në administratën e kompanisë e jo vazhdim i kontratës siç pretendohet duke u bazuar në faktin që e paditura asnjëherë nuk ka ripërtërirë kontratë me paditësin nga provat që gjinden në shkresat e lëndës.

Për këtë arsye bordi i drejtorëve të paditurës në mbledhjen e dt. 20.08.2018 ka marrë vendim nr. ...4 dhe shpall konkurs për pozitën Zyrtar i Lartë / Sekretar i kompanisë, ky konkurs ka qenë i publikuar në ëebfaqen e kompanisë dhe në shtypin ditor, i hapur për aplikim për pesëmbëdhjetë ditë duke filluar nga dt. 31.08.2018-14.09.2018 dhe paditësi ka aplikuar në konkursin e lartcekur, gjë që vërteton se i njëjti ka qenë i informuar andaj që të ketë mundësinë e vazhimit të pozitës së sekretarit, është dashtë të konkuroj dhe ti nënshtrohet procedurave të rekrutimit veprim të cilin e ka bërë.

Pas shqyrtimit të dokumenteve të aplikantëve, komisioni për shqyrtimin e dokumentave në mbledhjen e dt. 19.09.2018 me njoftimin për anulim nr. 3730 anulon konkursin nr. ... (plotësimi nr. 3...), duke u bazuar në nenin 6, pika 5.1 të Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik.

Më dt. 09.10.2018 bordi i drejtorëve të paditurës rishpall konkurs nr. .../18 për pozitën Sekretar i kompanisë, publikon në ëbfaqe dhe në gazetë ditore, i hapur për aplikim nga dt. 10.10.2018-24.10.2018 dhe paditësi përsëri aplikon në konkursin e rishpallur, kjo vërteton se i njëjti ka qenë i informuar edhe për konkursin e rishpallur nr. ...8/18.

Pas shqyrtimit të dokumenteve të aplikantëve, komisioni për shqyrtimin e dokumentave në mbledhjen e dt. 19.11.2018 me njoftimin për anulim nr. 4... anulon konkursin nr. ...8/18, duke u bazuar në nenin 6, pika 5.1 të Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik.

Më dt. 13.11.2018 bordi i drejtorëve të paditurës rishpall konkursin nr. 4131 për pozitën Sekretar i Kompanisë, publikon në ëbfaqe dhe shtypin ditor i hapur për aplikim nga dt. 14.11.2018-28.11.2018. Paditësi aplikon në konkursin e rishpallur nr. ...1 duke u radhitur i dyti në listën përfundimtare. Nga rezultatet e listës përfundimtare nr. 137 të konkursit nr. ..1, përqindjen e pikëve të fituara në total i ka 72% (73 % në intervistën me shkrim dhe 71% në intervistën me gojë) i radhur i dyti në listë sipas përqindjes së pikëve. Andaj bordi i drejtorëve të paditurës duke u bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, neni 11, pika 10 ku thuhet se: “Lista definitive përpilohet duke renditur pjesëmarrësit në testim dhe në intervistë sipas renditjes së pikëve të fituara nga testi dhe intervista” kishte vendosur ta shfuqizonte vendimin nr. 3...3 të dt. 03.08.2018 për vazhdimin e kontratës së sekretarit të kompanisë Krm P. sh.a Ferizaj i paraparë të jetë në fuqi deri në një vendim tjetër, shfuqizoj vendimin nr ...4 të dt. 03.08.2018 për vazhdimin e kontratës së zyrtarit të lartë për financa dhe thesar “Krm P.” sha në Ferizaj i paraparë të jetë në fuqi deri në një vendim tjetër. Në fq. 2 të këtij vendimi te këshilla juridike thuhet se: “Kandidatët e pakënaqur mund të ushtrojnë ankesë në afat prej 8 ditësh, nga dita e publikimit të rezultateve pranë Bordi i Drejtorëve të KRM P. Sh.a Ferizaj rr. ... nr. 4...

Gjithëherë i kënaqur me rregullsinë e procedurave të përcjella nga bordi i drejtorëve, respektivisht komisioni vlerësuar për pozitën e sekretarit, mënyrën se si procedurat kanë shkuar konform ligjit, duke qenë edhe vet pjesë e këtyre zhvillimeve dhe duke i përcjellë nga afër dhe



kjo vërtetohet me aplikim në çdo konkurs të shpallur e rishpallur për pozitën e sekretarit të kompanisë, paditësi kishte aplikuar edhe herën e tretë kur shpallet konkursi për pozitën e sekretarit, me nr. 4331, në të cilin konkurs ishte vlerësuar me pikë i dyti e jo i pari.

Ndaj këtij vendimi kishte ushtruar më dt. 01.02.2019, ankesë nr. 182 kundër njoftimit nr. 138 datë 28.01.2019 të Komisionit përzgjedhës për pozitën zyrtar i lartë / sekretar i kompanisë, drejtuar bordit të drejtorëve të KRM P. Sh.a në Ferizaj.

Bordi i drejtorëve të KRM P. Sh.a në Ferizaj me vendimin nr. ...82, datë 01.02.2019, pika I. refuzohet si e pabazuar ankesa me nr. ...2 datë 01.02.2019 e parashtruar nga S.H. kundër përzgjedhjes së bërë sipas njoftimit për kandidatët e suksesshëm nr. 138 datë 28.01.2019 për pozitën zyrtar i lartë / sekretar i kompanisë, pika II. lihet në fuqi njoftimi për kandidatët e suksesshëm nr. 1...8 datë 28.01.2019. Në këtë vendim fq. 3 te këshilla juridike thuhet: “Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit në Gjykatën Themelore në Ferizaj”.

Ndërsa paditësi padinë e kishte paraqitur në gjykatë më dt. 25.02.2019 (gjë që vërtetohet nga leximi i vulës së pranimit në fq. e parë të padisë) kurse në vulën e pranimit në sistemin elektronik SMIL shkruan dt. 18.06.2019.

Me vendimin nr. 136 të dt. 28.01.2019 emërohet z. A.Q. nga Ferizaj sekretar i kompanisë me mandat 3 vjeçar, pas kryerjes së procedurës së intervistimit anëtarët e komisionit për intervistim paraqitën raportin nr. 134 për kandidatët e intervistuar, ku bordi i drejtorëve të paditurës me shumicë votash zgjedhën kandidatin i cili më së miri i plotësoj kushtet e konkursit dhe muarr vendim si në dispozitiv.

Në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se ndaj këtij konkursi publik ku ka marrë pjesë paditësi të jetë inicuar ndonjë procedurë gjyqësore e çfarëdo natyre përmes të cilës do të kontestohet ligjshmëria dhe drejtshmëria e tij. Andaj po që se gjykata do të mirrte vendim përmes të cilit paditësi do të kthehej në vendin e punës në cilësinë e sekretarit të kompanisë ndërsa duke pas parasysh faktin se konkursi nr. ...31 përmes të cilit është zgjedhur sekretari i kompanisë ndërsa ndaj konkursit nuk është inicuar procedurë gjyqësore qoftë e natyrës civile, administrative, penale etj. do të mund të shkelte të drejtat e fituara të personave të tretë nga ky konkurs publik gjë që mund të përbënte shkelje të parimit të sigurisë juridike. Për këtë arsye duke marrë për bazë konkursin e të paditurës në pozitën e Sekretarit në KRM P. me seli në Ferizaj, e duke u bazuar në nenin 68 të Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit për Ndërmarrjet

Publike dhe plotësim/ndryshimet e këtij ligji, gjykata gjeti se procedura për punësim në pozitën e Sekretarit në KRM P. me seli në Ferizaj, është realizuar në mënyrë të rregullt, ashtu që të drejtë konkurrimi kanë pasur të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet paraprake të konkursit, për çka, gjykata erdhi në përfundim se të gjithë kandidatët të cilët kanë konkurruar për pozitën e Sekretarit, kanë pasur të drejtë të konkurojnë në pozitën përkatëse me të gjitha të drejtat e plota, duke mos përjashtuar këtu as kandidatin e përzgjedhur për pozitën gjegjëse, dhe as paditësin i cili konteston vendimin e të paditurës.

Kërkesa e paditësit që të detyrohet e paditura që ta kthejë në vendin e punës u refuzua si e pabazuar, meqenëse, gjykata nuk ka bazë ligjore dhe nuk ka tagër që të detyroj të paditurën që të njëjtin ta kthejë në vendin e punës, përpos nëse do të vërtetohej se ka pasur diskriminim, përndryshe gjykata është e autorizuar të ekzekutoj vetëm dëmshpërblimin adekuat në të holla për punëmarrësin, nëse do të vërtetohej se të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë të kundërligjshme. Paditësi nuk ka paraqitur ndonjë provë se mospërzgjedhja e tij të jetë bërë për shkaqe të diskriminimit. Gjukata ka bazë ligjore rrjedhimisht është e autorizuar që të kthejë të punësuarin në vendin e tij të punës sipas nenit 80, paragrafit 1, pika 1.2 të Ligjit të Punës vetëm kur vërteton faktin se largimi nga puna është i paligjshëm sipas nenit 5 të Ligjit të Punës, i cili nen i referohet diskriminimit në vendin e punës (sipas Ligjit kundër diskriminimit), e që në rastin konkret nga vlerësimi i gjykatës rezultoi se nuk kemi të bëjmë me ndonjë lloj të diskriminimit në vendin e punës të pësuar nga paditësi. Meqenëse gjykata e ka refuzuar kërkesën e paditësit për anulimin e vendimit të kontestuar, atëherë kërkesa për dëmshpërblim është vetvetiu e pabazuar, në këtë drejtim poashtu nuk i falet besimi as ekspertizës financiare dhe plotësimi të saj sepse janë irelevante, për faktin se paditësi ka dështuar në të provuarit e kërkesës së tij, meqë barra e provës i ngarkohet atij, si palë, me kërkesën e të cilit është inicuar ky kontest. Përveç të cekurave më lart, është vlerësim i kësaj gjykate se themelimi i marrëdhënies së punës dhe përcaktimi i kushteve të punës i referohet normave ligjore të karakterit dispozitiv duke i lejuar palëve të drejtën, por pa i cenuar dispozitat ligjore të karakterit imperativ. Gjukata, me rastin e vendosjes kishte parasysh këto dispozita ligjore dhe kërkesat e palës paditëse meqë në procedurën civile gjykata vepron brenda kërkesave të palëve (neni 2.1 i LPK) dhe se kërkesat e tilla palët janë të obliguara që ti provojnë. Andaj, nga të gjitha vlerësimet e lartëcekura, gjykata vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjukata, ligjshmërinë e vendimit me nr. 131, të datës 25.01.2019 të të paditurës e ka bazuar edhe në faktin se e njëjta për zgjedhjen e kandidatit për pozitën e sekretarit, ka mbajtur

testin me shkrim përmes një procesi të rregullt, ashtu që, kandidati-paditësi është ranguar në pozitën e dytë, përqindjen e pikëve të fituara në total i ka 72% (73 % në intervistën me shkrim dhe 71% në intervistën me gojë) i radhur i dyti në listë sipas përqindjes së pikëve, me çka bazuar në nenin 69, par.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, në të cilin theksohet se “në rastin e konkurrimit të organizuar për një pozitë të vetme, kandidati që ka marrë më shumë pikë dhe është vlerësuar mbi nivelin minimal është kandidati fitues”, gjykata gjeti se është në diskrecionin e lirë të të paditurës të bëjë vlerësueshmërinë e subjektit përkatës për pozitën e paraqitur si në konkursin e shpallur. Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës. Andaj, konform nenit 322, par. 1 të LPK, paditësi ka dështuar në argumentimin e pretendimit të tij në këtë drejtim edhe gjykata nuk mund t’ia falë besimin të njëjtë. Gjykata, në rastin konkret, me asnjë provë të cilat janë administruar nuk ka gjetur elemente të diskriminimit në raport me paditësin, andaj e njëjta ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Paditësi, edhe pse në kërkesën e tij nuk kishte pretenduar se është diskriminuar, por gjykata lidhur me këtë i referohet nenit 5, par. 3 të Ligjit të Punës në të cilin theksohet se: “nuk konsiderohet diskriminim, çdo dallim përjashtim ose dhënie e përparësisë, përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune, në bazë të kriterëve të caktuara që kërkohen për atë vend pune”, meqë rast gjykata ka formuar bindjen se kandidati i përzgjedhur ka plotësuar çdo kusht të kërkuar me anë të konkursit publik të shpallur nga e paditura dhe se është në diskrecionin e lirë të të njëjtës të bëjë vlerësueshmërinë e të gjithë kandidatëve që i nënshtrohen procedurës së testimit, CV-së apo përvojës së punës, që këta të fundit ofrojnë. E rëndësishme për gjykatën për të vendosur lidhur me këtë çështje juridike kontestimore ishte ekzistimi i të provuarit se nuk janë shkelur procedurat lidhur me konkursin publik të shpallur për pozitën e sekretarit të KRM P. me seli në Ferizaj, dhe se nuk ka patur asnjë diskriminim nga ana e të paditurës, andaj edhe gjykata nuk ka mundur të konstatojë se në rastin konkret kishte ndonjë shkelje ligjore në zhvillimin e procedurës dhe vendimin e të paditurës. Fakti që paditësi nuk e ka pranuar juridikisht vendimin nr. 131 të dt. 25.01.2019 nuk ka efekt në vendosje ndryshe sepse me aplikimin në konkurset (tri) e shpallura nga e paditura ai faktikisht dhe juridikisht kishte qenë i njoftuar për faktin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së tij. Po ashtu me nenin 7.1 të LPK është paraparë se “Palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”, ndërsa që me nenin 7.2 të po këtij ligji decidivisht ceket se “Gjykata është e autorizuar që t’i vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur, si dhe t’i marrë provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga

rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar me nenin 3 par.3 të këtij ligji).

Pretendimet e paditësit për kinse manipulimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të drejtorëve të dt. 25.01.2019, me numër 131, janë të pambështetura në prova dhe fakte dhe si të tilla janë të paqëndrueshme, nëse paditësi pretendon se dikush mund t'i ketë manipuluar të dhënat në këtë procesverbal ka mundur t'i drejtohet organeve përkatëse shtetërore me ngritjen e kallëzimit penal ose me inicimit e rastit në polici mirëpo nga shkresat e lëndës nuk gjindet prova e cila do të vërtetonte se ka ndërmarrë një veprim të tillë. Kurse lidhur me këtë çështje decidivisht në nenin 16 të Statutit të paditurës thuhet se, Sekretari i Kompanisë (“sekretari”) do të jetë përgjegjës: 1.6. Sekretari do të mbaj procesverbalin e secilës mbledhje të përgjithshme të bordit të drejtorëve dhe komisionit të auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesi i tyre) dhe do ti shënoj ato në librat e protokolleve. Procesverbali do të përmbajë këto informata: emrat e personave pjesëmarrës, vendin dhe kohën e mbledhjes, çështjet kryesore të ngritura gjatë diskutimit të pikave të veqanta të agjendës, tekstin e veprimeve të propozuara, rezultatin e secilit votim dhe të votave të secilit individ (pjesëmarrës), tekstin e saktë të vendimeve të arritura si dhe çfarëdo kundërshtimi i ngritur në lidhje me vendimet e marra; 1.7. Procesverbali për mbledhjet e përgjithshme do të nënshkruhet nga kryesuesi i mbledhjes së përgjithshme dhe nga sekretari dhe do të dërzohet për aprovim në mbledhjen e ardhshme të përgjithshme. Sekretari do të lëshoj kopje të certifikuara të procesverbalit. Procesverbali i mbledhjes së përgjithshme do tu vihet aksionarëve në dispozicion me kërkesën me shkrim 1.8. Procesverbali i secilës mbledhje të bordit të drejtorëve për aprovim në mbledhjen e ardhshme të bordit të drejtorëve. Procesverbali i secilës mbledhje të bordit të drejtorëve do të nënshkruhet nga ana e kryesuesit të bordit të drejtorëve dhe do tu shpërndahet anëtarve të bordit të drejtorëve. Të njëjtat rregulla do të zbatohen për procesverbalet e komisionit të auditimit.”

Nga vlerësimi i fakteve të çështjes gjykata fillimisht gjeti se pozita e Sekretarit pozitë të cilën e kishte paditësi është pozitë menaxheriale apo pozitë për zyrtarë të lartë publik, ndërsa nga analizimi i dispozitave ligjore gjeti se për pozitën në fjalë emërimi, shkarkimi, detyrat, kompetencat rregullohen me Ligjin për Ndërmarrjet Publike-Ligji nr. 03/L-087. Vendimi nr. 131 i dt. 25.01.2019 është i drejtë dhe i ligjshëm edhe atë konform nenit 21 par. 1, të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, andaj edhe gjykata nuk ka mundur të konstatoj se në rastin konkret kishte ndonjë shkelje ligjore në zhvillimin e procedurës për anulim të këtij vendimi në raport me paditësin. Kjo meqë duke aplikuar ligjin e lartcitur, Bordi i Drejtorëve ka të drejtë sikurse të

emëroj ashtu edhe të shkarkoj zyrtarët e lartë të Ndërmarrjeve Publike, pozitë kjo e cila është edhe Sekretari i kompanisë së paditurës e cila është ndërmarrje publike. Po ashtu neni 21, paragrafi 2, parasheh mundësinë e shkarkimit të zyrtarit të lartë nga Bordi edhe pa cekur arsyen e shkarkimit. Nga procesverbali i dt. 05.02.2019 gjykata vërtetoi se Bordi i Drejtorëve kishte mbajtur mbledhjen, ku ndër të tjera në pikën nr. 2 të rendit të ditës kishte vendosur edhe për aprovimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar dhe atë me shumicë votash, ku të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e bordit. Kjo mënyrë e veprimit është në përputhshmëri me statutin e të paditurës, gjegjësisht neni 16, pika 1.8 e Statutit të paditurës ku thuhet se, procesverbali i secilës mbledhje të bordit të drejtorëve për aprovim në mbledhjen e ardhëshme të bordit të drejtorëve. Në këtë pjesë gjykata ia fali në tërësi besimin deklaratave të dëshmitarëve Skender Hyseni dhe Dukagjin Etemi, ndërsa nuk ia fali besimin deklaratës së dëshmitarit Habib Krosa.

Në një situatë të tillë nisur nga fakti se pozita e Sekretarit është pozitë e cila bën pjesë në pozitat e zyrtarëve të lartë në ndërmarrjet publike, ndërsa emërimi, shkarkimi i zyrtarëve të lartë në ndërmarrjet publike rregullohet me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, gjykata vlerësoi se në rastin konkret ligj i aplikueshëm është Ligji për Ndërmarrjet Publike - Ligji nr. 03/L-087, si ligj special.

Gjykata fiillimisht sjellë në vëmendje se në kontest nga marrëdhënia e punës, është e domosdoshme që në çdo fazë të procedurës të përqendrohet në vlerësimin e faktit nëse janë përmbushur dy parakushte apo prezumime bazë: 1) që i punësuar – paditësi, para se të kërkojë realizimin e të drejtës së pretenduar në rrugë gjyqësore, paraprakisht i ka shfrytëzuar procedurat interne pranë punëdhënësit dhe 2) nëse padia është dorëzuar brenda afateve të përcaktuara me ligj. Prezumimet në fjalë duhet përmbushur në mënyrë kumulative, në mënyrë që të ofrohet mbrojtje gjyqësore lidhur me të drejtat e pretenduara që burojnë nga marrëdhënia e punës. Qëllimi i dispozitave të lartcekura ka të bëjë me inkurajimin e arritjes së një zgjidhje përmes konsumit të procedurave interne, duke i dhënë një lloj përparësie një procedure të tillë karshi mbrojtjes gjyqësore, e cila duhet të vijë në shprehje si alternativë e fundit. Ky vlerësim i Gjykatës gjen mbështetje edhe në qëndrimet e shprehura nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës përmes Përmbledhjes nga Praktika e Gjykatës Supreme në Çështje Penale dhe Civile, Prishtinë, 2023, gjegjësisht në kapitullin VII - Kontestet e punës, shqyrtimi paraprak i padisë, afati për paraqitjen/lejueshmërinë e padisë si prezumim procedural. Gjegjësisht në faqen 501 të kësaj përmbledhje, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, shprehimisht potencon: “Pra, i punësuar nuk mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore sa i përket të drejtave nga marrëdhënia e

punës, pa i shterur paraprakisht procedurat interne (mjetet e brendshme)”. Vlen të ceket se paditësi në procedurën e zhvilluar para gjykatës së shkallës së parë kishte paraqitur padi për kthimin në vendin e punës gjë që vërtetohet nga leximi i referatit të padisë ndërsa në procedurën e rigjykimit të zhvilluar para gjykatës së shkallës së parë pas kthimit të lëndës në rigjykim nga Gjykata e Apelit, paditësi e ka zgjeruar padinë dhe kërkesëpadinë me parashtrësën e dt. 14.02.2023, edhe për anulimin e vendimit nr. 131 të dt. 25.01.2019.

Gjykata vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në bazë të neneve 450, 452 dhe 463 të LPK-së, pasi që paditësi ka humbur procesin gjyqësor, ndërsa pala e paditur i ka kërkuar shpenzimet e procedurës por të njëjtat nuk i ka specifikuar.

Gjykata i pati parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse, por disa prej pretendimeve që i cilësoi si irelevante nuk i arsyetoi veç e veç, për shkak se nuk çuan peshë në vendosjen ndryshe të kontestit. Ndërsa Neni 6 i KEDNJ kërkon që gjykatat vendase të japin arsye mbi vendimet e tyre si në çështjet civile, ashtu edhe në ato penale. Gjykatat nuk janë të detyruara të japin përgjigje të detajuara për çdo pyetje, por nëse një kërkesë është thelbësore për rezultatet e çështjes, gjykata atëherë duhet që specifikisht t'i trajtojë ato në gjykimin e tij, qëndrim i mbajtur në rastin Van de Hurk kundër Holandës, aplikacioni nr. 16034/90, të dt. 19.04.1994, par. 61. Ndërkaq sipas nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës, të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Nga të lartcekurat, e në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**2022:234810, më datë 03.06.2024**

**Gjyqtari,**

**Armend Ahmeti**

**UDHËZIMI MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në këtë gjykatë dhe i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë.